



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 70/2021 (JR)  
Nr. 70/ h regj.

Tiranë më 21.3. 2024

**SHPALLJE  
E  
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e martë datë 30.04.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me nr. regjistri (JR) nr. 70/2021, datë 16.11.2021, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Lindita Sinanaj kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 417, datë 08.07.2021.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.  
Trupi Gjykses, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesues i Trupit Gjykses</b>	<b>Sokol Çomo</b>
<b>Relatore e Çështjes</b>	<b>Ina Rama</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Mimoza Tasi</b>
<b>Gjyqtare</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES  
GJYQTAR**

**SOKOL ÇOMO**

  
